

Vendim nr. 245 datë 22.10.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Marsida Xhaferllari, anëtarë, në datën 22.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 8 (B) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **BENARD CAPA**, përfaqësuar nga avokat Tauland Asllanaj, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 6421, datë 11.11.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 338, datë 02.02.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-1829, datë 02.05.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 31, 33, 42, 142, pika 1, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Benard Capa prej vitit 2013 ka ushtruar detyrën e inspektorit në sektorin e verifikimit në terren në Drejtorinë Rajonale Tatimore, Dibër (*DRT*). Në datën 21.03.2014 ai është caktuar në përbërje të grupit të punës për të kryer kontroll pranë disa subjekteve tregtare në Bulqizë. Drejtori i *DRT*-së, pasi ka vërejtur se aktkonstatimi i përpiluar nga inspektorët përmbante korrigjim që lidhej me të dhënat e subjektit të kontrolluar, ka vlerësuar se ai përbënte shkelje të rëndë disiplinore, për të cilën ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” parashikonte largimin nga detyra dhe ka njoftuar me shkrim drejtorin e përgjithshëm të Tatimeve. Ky i fundit, në datën 10.06.2014, e ka njoftuar me shkrim kërkuesin për fillimin e procedurës disiplinore, duke e vënë në dijeni edhe për mundësinë e paraqitjes me shkrim të sqarimeve dhe për të drejtën për t’u paraqitur në Komisionin e Disiplinës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (*Komisioni i Disiplinës*).

2. Komisioni i Disiplinës e ka shqyrtuar çështjen në datat 24.06.2014 dhe 17.07.2014, duke dëgjuar edhe shpjegimet e kërkuesit. Në përfundim, me vendimin nr. 1105, datë 16.07.2014, Komisioni i Disiplinës ka vendosur marrjen e masës disiplinore të largimit të kërkuesit nga Shërbimi Civil. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur kërkesë për revokimin e vendimit të largimit nga detyra, Komisioni i Disiplinës ka vendosur refuzimin e saj.

3. Në datën 02.09.2014 kërkuesi ka paraqitur padi në gjykatë me objekt shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Disiplinës për dhënien e masës disiplinore, rregullimin e të gjitha pasojave, rikthimin në vendin e punës dhe kryerjen e pagesave. Në vijim, në datën 02.12.2014, kërkuesi ka paraqitur edhe kallëzim penal për veprën penale të falsifikimit të aktkonstatimit, duke pretenduar se nënshkrimi në këtë akt nuk ishte i tij.

4. Në lidhje me kallëzimin, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin e datës 12.07.2017, ka vendosur pezullimin e hetimeve, me arsyetimin se autori i veprës penale, pra personi që kishte nënshkruar aktin në emër të kërkuesit nuk njihej. Ndërsa, për sa i takon padisë administrative, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 6421, datë 11.11.2014, ka vendosur rrëzimin e saj.

5. Megjithëse kërkuesi ka paraqitur apel, vendimi i rrëzimit të padisë është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 338, datë 02.02.2017. Në vijim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1829, datë 02.05.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

6. Në datën 14.08.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), nëpërmjet shërbimit postar, me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuetit

7. **Kërkueti**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara janë pasojë e një procesi të parregullt ligjor në aspektet e mëposhtme:

- 7.1. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka anashkaluar prova të rëndësishme shkresore (deklaratat e të pranishmëve, ekspertimin grafik dhe aktet e tjera të hetimit paraprak), të paraqitura nga kërkueti dhe të pashqyrtuara nga gjykata e apelit. Gjykata e Lartë nuk ka kontrolluar nëse ligji procedural është zbatuar drejt nga gjykatat e faktit, për sa i përket vlerësimit dhe shqyrtimit të provave shkresore. Ajo nuk ka analizuar as pretendimin e kërkuetit se provat e paraqitura nuk janë marrë në konsideratë.
- 7.2. *Parimi i gjykimit nga një gjykatë e paanshme*, pasi gjykata e apelit ka mbajtur qëndrim të njëanshëm, për sa i përket vlerës së provave, duke zhvlerësuar ato që provonin bazueshmërinë e pretendimeve të kërkuetit dhe duke vlerësuar prova të parregullta të palës së paditur. Gjykata e apelit e ka mbështetur vendimin në akte të falsifikuara dhe ka anashkaluar aktet e hetimit paraprak.
- 7.3. *Parimi i barazisë së armëve*, pasi gjykata e apelit e ka vendosur kërkuetin në pozita të pabarabarta dhe të disfavorshme ndaj palës tjetër, argumentet e së cilës kanë marrë përparësi, edhe pse mbështeteshin në akte të falsifikuara.
- 7.4. *E drejta për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi gjykata e apelit e ka mbajtur çështjen 2 vjet në pritje. Edhe Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen tej afatit të arsyeshëm ligjor, pas 7 vjetëve nga regjistrimi i saj.
- 7.5. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykata e apelit ka nxjerrë përfundimin se kërkueti ishte në punë ditën e kontrollit edhe pse ka konstatuar faktin se nënshkrimi në aktkonstatim nuk ishte i tij, duke i dhënë përparësi një akti tjetër të hartuar nga përgjegjësi dhe duke zhvlerësuar ekspertimin grafik. Përfundimi i gjykatës së apelit se në të njëjtën ditë kërkueti kishte nënshkruar dhe një tjetër aktkonstatim bazohet në një deformim të rëndë dhe me dashje të rrethanave dhe provave. Vlerësimi i gjykatës së apelit ka qenë i cekët, jo serioz dhe i njëanshëm, i paqartë, jokohorent dhe me argumente kundërthënëse, si dhe

nuk i ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuarit. Edhe Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje asnjë prej pretendimeve të parashtruara në rekurs lidhur me cenim e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, gjykimin nga një gjykatë e paanshme, si dhe parimit të barazisë së armëve.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuarra në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimin kushtetues.

10. Në lidhje me legjitimitimin *ratione personae*, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuari, si individ, legjitimohet në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor, në të cilin janë dhënë vendimet e kundërshtuara, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

11. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete (*shih vendimet nr. 31, datë 29.05.2023; nr. 15, datë 11.03.2021; nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin në shqyrtim, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, me argumentin se procesi gjyqësor i tij ka zgjatur pothuajse 10 vjet, prej të cilave 2 vjet në gjykatën e apelit dhe 7 vjet në Gjykatën e Lartë. Sipas tij, ai e ka ngritur këtë pretendim në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës së Lartë, madje ka kërkuar edhe përshpejtimin e çështjes prej saj, por nuk ka marrë përgjigje. Nga shqyrtimi i akteve që kërkuesi i ka bashkëlidhur ankimit të tij dhe akteve të dosjes gjyqësore të Gjykatës së Lartë, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se në to nuk gjendet ndonjë kërkesë drejtuar Gjykatës së Lartë për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procesit bazuar në nenet 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile. Për këto të fundit, Gjykata ka pohuar se janë mjete juridike që ofrojnë rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese dhe vetëm pasi t'i ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen prej tyre nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 44, datë 26.09.2023; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto rrethana, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, për pasojë pretendimi i tij për cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm nuk mund të merret në shqyrtim.

13. Për sa u takon pretendimeve të tjera, Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit në Gjykatën e Lartë dhe pasi ka parashtruar formalisht dhe në substancë pretendimet e tij, për rrjedhojë ka plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

14. Në vijim, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000. Vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 02.05.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 14.08.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

15. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e parimeve të gjykatës së paanshme dhe të barazisë së armëve, duke parashtruar në thelb të njëjtat argumente, që kanë të bëjnë me vlerësimin e provave të tij nga gjykata e apelit në raport me provat e paraqitura nga pala kundërshtare. Më konkretisht, kërkuesi ka parashtruar se gjykatat e zakonshme nuk kanë vlerësuar në mënyrën e duhur aktet e hetimit paraprak të çështjes penale, në veçanti aktin e ekspertimit grafik, që sipas tij, provonin se ai nuk kishte nënshkruar aktkonstatimin e korigjuar, që përbënte shkakun e procedimit të tij disiplinor. Sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë nuk i ka korigjuar këto shkelje, ndonëse ai i ka parashtruar

ato në rekurs. Duke mbajtur në konsideratë thelbin e argumenteve të kërkuarit, Mbledhja e Gjyqtarëve do t'i shqyrtojë pretendimet e tij në këndvështrim të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit.

16. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve, atëherë argumentet e njëres palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar, për rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, Gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 22, datë 22.09.2022; nr. 8, datë 23.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se në çështjen konkrete gjykata e apelit është shprehur se ekspertimi grafik i aktkonstatimit dhe aktet e tjera të hetimit paraprak, të paraqitura si prova nga kërkuari, nuk provojnë falsitetin e aktit dhe as faktin se ai nuk ka qenë në punë atë ditë. Për të arritur në këtë përfundim, gjykata e apelit ka arsyetuar se falsiteti i aktit duhet të provohet me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe se pretendimi se kërkuari nuk ka qenë në punë atë ditë nuk gjen mbështetje nga përmbajtja e provave të tjera të shqyrtuara, duke filluar nga listëpagesa e institucionit deri tek aktet e tjera të kontrollit të subjekteve të tjera.

18. Për sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se, ndryshe nga sa pretendon kërkuari, gjykata e apelit i ka dhënë atij mundësi të barabarta me palën tjetër për të paraqitur argumentet dhe provat, përfshirë aktet shkresore, ndaj pretendimi për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit është haptazi i pabazuar. Për më tepër, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se argumentet e kërkuarit, në thelb, kanë të bëjnë me vlerësimin e provave për zgjidhjen e çështjes së tij nga gjykatat e zakonshme, që nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues (*shih vendimet nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 45, datë 23.07.2012; nr. 31, datë 05.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*) dhe, si të tilla, ato nuk mund të merren në shqyrtim.

19. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuari ka ngritur edhe pretendime të tjera që lidhen me cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, duke parashtruar argumente, të cilat, në thelb, kanë të bëjnë

me mënyrën se si gjykatat kanë arsyetuar në vendimet e tyre. Më konkretisht, kërkuesi ka parashtruar se vlerësimi i gjykatës së apelit ka qenë i paqartë, jokoherent dhe me argumente kundërthënëse, ndërsa Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura prej tij në rekurs.

20. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42 i Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, i cili përkon edhe me detyrimin e gjykatave për të arsyetuar vendimet, sipas nenit 142, pika 1, të Kushtetutës. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje dhe në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Me arsyetimin, gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 42, datë 25.05.2017; nr. 25, datë 10.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Po kështu, Gjykata, në mënyrë konstante, ka pohuar se vendimet e mospranimit të rekursit mund të arsyetohen nga Gjykata e Lartë në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Arsyetimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa shpreh, në thelb, shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 12, datë 15.03.2023; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Duke iu rikthyer çështjes në shqyrtim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se gjykatat e faktit kanë arsyetuar vendimet e tyre, duke vlerësuar provat e paraqitura, mbi bazën e të cilave kanë përcaktuar faktin se kërkuesi ishte paraqitur në punë atë ditë dhe kishte ushtruar detyrën në zonën ku ishte mbajtur aktkonstatimi i korrigjuar, që ishte bërë shkak për largimin e tij nga puna. Në përmbajtjen e vendimeve të tyre nuk konstatohen paqartësi ose të meta të nivelit kushtetues, që të vënë në dyshim respektimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

23. Për sa i takon Gjykatës së Lartë, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se ajo në pjesën hyrëse të vendimit ka treguar shkaqet e rekursit, ka arsyetuar për to në pjesën vlerësuese dhe u ka dhënë përgjigje në nivel të mjaftueshëm atyre, duke analizuar ligjin për nëpunësin civil dhe

dispozitat procedurale të zbatueshme, si dhe duke theksuar se vlerësimi i provave del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Sipas Gjykatës së Lartë, kërkuesi nuk mund të pretendojë që nëpërmjet rekursit dhe gjykimit në atë gjykatë të rihapë edhe një herë shqyrtimin gjyqësor të provave, pasi ky aspekt është mbyllur me përfundimin e gjykimit në gjykatën e apelit. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë ka vepruar brenda kompetencave kushtetuese të saj, si gjykatë ligji, ndërsa në përmbajtjen e vendimit të saj nuk vihen re kundërthënie, paqartësi ose të meta të nivelit kushtetues.

24. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se pretendimet e kërkuetit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, janë haptazi të pabazuara.

25. Si përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se çështja nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.